

Shënim i autorit

Si gazetar i rritur në Amerikën e viteve Shtatëdhjetë, gjithnjë jam joshur nga intervistat Frost-Nikson, seria e famshme e ballafaqimeve televizive kokë më kokë që gazetari anglez David Frost zhvilloi me Riçard Niksonin në pranverën e vitit 1977, mëse dy vjet pas dorëheqjes dramatike të presidentit.

Në adoleshencë isha i fiksuar pas Uotergejtit, ashtu siç fiksohen të rinjtë e sotëm pas videolojërave apo Facebook-ut. Intriga. Incizimet sekrete të Shtëpisë së Bardhë. Orvatja për të hedhur hi syve për gjithçka. Scoop-et e reporterëve të “Washington Post”, Bob Uduord dhe Karl Bernshtejn. Poshtërimi i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës! Fjalja e famshme e Niksonit: “Njerëzit duhet ta dinë nëse presidenti është një keqbërës. Epo, unë nuk jam një keqbërës”.

S’kisha të nginjur me kësi gjërash. Mezi prisja të dilnin seritë e reja të sagës për t’i përpirë, njëra pas tjetrës, si karamelë.

Në verën e 1974-ës, në shtëpinë tonë të pushimeve në veri të shtetit të Nju Jorkut, e detyroja time motër, trembëdhjetë vjeç asokohe, të shikonte me mua çdo ditë dëgjesat për *impeachment*, që kulmuan në gusht me dorëheqjen e presidentit. E pamë kur dha dorëheqjen në transmetim të drejtpërdrejtë, pastaj kur i dha lamtumirën stafit të Shtëpisë së Bardhë, me atë përshëndetje të çuditshme, atë gjest të dëshpëruar me të cilin i drejtohej popullit amerikan para se të hipte në helikopterin që e priste në lëndinë, për të shkuar në bazën ajrore të Endrijusit dhe prej aty, tashmë i pllakosur nga fatkeqësia, të niste fluturimin e gjatë drejt mërgimit në Kaliforni.

Tërë këto kujtime buisën rrëmbyeshëm në kujtesën time në fillim të 2014-s, kur Rizzoli, botuesi im italian, më propozoi ta bindja Silvio Berluskonin, liderin më të hovshëm dhe polemik të historisë së re politike, të më rrëfente mua historinë e jetës së tij. E njoh Berluskonin prej tridhjetë vjetësh, që kur mbërrita në Milano si korrespondent i “Financial Times” të Londrës, në vitet Tetëdhjetë. Në disa rrethana, kam qenë kritik i ashpër ndaj tij; pastaj historia e tij vetjake sikur po më ngjallte kureshtje. Nuk është fjala thjesht për festat e përfolura *bunga-bunga* ose proceset për korrupsion: ajo që më grish është jeta e tij e jashtëzakonshme, epike. I ndoqa nga afër ngjarjet që çuan në rënien e tij, në vitin 2011, dënimin e Kasacionit për mashtrim fiskal në gusht 2013, dëbimin nga Senati që erdhi më pas. Pavarësisht këtyre ngjarjeve, Berlusconi vazhdonte dhe vazhdon edhe sot të lëshojë një hije gjatoshme mbi politikën dhe shoqërinë italiane, dhe kjo veçse e ushqen interesin tim.

Kur shkova për herë të parë ta pyesja nëse ishte i interesuar të vihej në gatishmëri për realizmin e këtij libri, nuk ushqeja shpresa të mëdha. Ishte mëngjes vonë i 12 marsit 2014. Ndodheshim në rezidencën e tij romane, në piano nobile* të Pallatit Grazioli, mes tavaneve plot afreske dhe tapicerive të praruara. Berlusconi, që asokohe

* **Piano nobile** është një element tradicional dhe tipik i pallateve fisnike urbane nga rilindja e hershme deri rreth shekullit XIX.

ishite shtatëdhjetë e shtatë vjeç, kishte mendim të mirë për mua, pikësëpari sepse jam amerikan (pra jo një gazetar italian, sipas tij plot paragjykime ndaj tij), por edhe sepse ndihej i çliruar nga libri që sapo kisha botuar, *Të vrasim Gatopardin*: një efekt anësor që pa dyshim nuk përfshihej në pikësynimet e mia.

E bëra me dije Berluskonin që kisha vendosur të shkruaja një libër rreth jetës së tij dhe i propozova të më mundësonte bashkëpunim të plotë, të më lejonte të shfrytëzoja arkivin e tij dhe të më siguronte komunikimin me familjarët, miqtë, partnerët në biznes dhe aleatët politikë. E sqarova që nuk do të kishte asnjë mundësi vetoje apo kontrolli mbi librin, por thjesht duhet të tregohej i gatshëm për intervistat e panumërta midis pranverës 2014 dhe fundit të verës 2015. Ai fillimisht m'i nguli sytë një copë herë të gjatë, pastaj më shpjegoi se dhjetëvjeçarin e fundit kishte kthyer mbrapsht të paktën pesëmbëdhjetë propozime të tilla. Shtova se nuk do të bëhej fjalë thjesht për një libër, por edhe për një gazetë a tridhjetë intervista televizive, sipas shembullit të serisë Frost-Nikson të 1977-ës. Ai vazhdonte të më vështronte ngultas, duke murmuritur diçka rreth faktit që, ishte e qartë, "sot gjithçka duhet të jetë multimediale", dhe befas më zgjati dorën. Ia shtrëngova, dhe Berlusconi foli fare shkoqur: "Kam besim te ju: e di që do ta rrëfeni historinë time në mënyrë të paanshme dhe të ndershme". E falënderova për besimin dhe i thashë thjesht: "Nuk do të jetë një agjiografi. Nuk do të shkruaj historinë e një shenjtori apo të një viktime, nuk do të tregohem armiqësor por s'do t'ju bëj asnjë favor, asnjë lëshim. Do të shkruaj në mënyrë të ekuilibruar historinë e një jete të jashtëzakonshme, ashtu siç e shoh unë; por ju do t'i përgjigjeni pyetjeve të mia për çdo kapitull të historisë tuaj dhe gjithçka do të regjistrohet".

Silvio Berlusconi i pranoi kushtet e mia. Më vonë, po atë ditë, një nga këshilltarët e tij do të më shpjegonte përse, sipas mendimit të tij, kishte thënë po: "Bota përreth po i shket nën këmbë dhe ndërsa ëndërron një tjetër ringritje politike e sheh këtë libër si një lloj testamenti dhe juve si dëshmitarin e tij: gazetarin e parë dhe të fundit të cilit do t'i besojë historinë e jetës, me fjalët e tij".

Gjatë tetëmbëdhjetë muajve që pasuan, nga pranvera e trazuar e 2014-s deri në fund të verës 2015, pata mundësi ta këqyrja Berluskonin nga shumë afër, pikësëpari në shtëpinë e tij. Ka pasur shumë bashkëbisedime dhe shumë intervista në një periudhë plot emocione për të, një periudhë e shënjuar nga doza të forta hidhërimi dhe ndonjë humbje, por njëherësh edhe nga projekte të vazhdueshme për rilindjen politike. Në njëfarë mënyre, pashë një udhëtim dramatik njerëzor të zhvillohet para syve të mi. Gëzova edhe privilegjin e pazakontë të një aksesit përnjëmend të lirë, që më dha mundësi të arrija ta njihja Berluskonin si njeri, mekanizmat e tij automatikë, skemat mendore, gjërat që e cingërisnin, batutat dhe anekdotat që kishte përzemër.

Ka pasur një periudhë të errët, kur sa herë shkoja ta intervistojta në Pallatin Gracioli në Romë apo në parkun e vilës mbresëlënëse të Arkores, ndodhte diçka e hidhur. Ndonjëherë, ndoshta kur ishte në pritje të vendimit të ndonjë prej proceseve të shumta gjyqësore ku qe përfshirë, e kaplonin emocionet. Shpesh, pas intervistës, më

kërkonte të rrinim e të diskutonim privatisht, dhe më fliste me zemër në dorë, për armiqtë, ndante me mua shqetësimet, shpresat, kënaqësitë dhe brengat e jetës së tij.

Gjithnjë e kam sqaruar Berluskonin se modeli im ishin intervistat që Frosti i bëri Niksonit. E kam përsëritur në shumë raste. Dhe kur e nisëm këtë projekt, s'di përse më erdhën në mendje fjalët më të famshme të shqiptuara nga presidenti Nikson gjatë atyre intervistave legjendare me David Frostin: "I bëra gropën vetes. U dhashë shpatën në dorë dhe ata ma ngulën drejt e në zemër, thellë e më thellë si të zijosur...".

Pyesja veten ç'do të rrëfente vallë Berlusconi për udhëtimin e pabesueshëm, epik të jetës së tij. Me kalimin e javëve dhe muajve, sigurisht që s'do të mbetesha i zhgënjyer.

Alan Friedman

Luka, 5 shtator 2015

My Way

Prolog

Moskë, e hënë 27 korrik. Bënte shumë nxehtë dhe një erë e fortë fshikullonte Sheshin e Kuq ku turistët gëlonin mizë lisi. Retë e zezë të mëngjesit ishin fshirë si me dorë dhe moti i kthjellët sundonte mbi Kremlin. Por, dihet, moti në Moskë mund të ndryshojë nga çasti në çast.

Për të mbërritur në Kullën Spasskaja, vendtakimi me stafin e presidentit Putin, duhet të kaptoja sheshin e pamatë. Përgjatë murit lindor të Kremlinit ngrihej mauzoleu i Leninit, një ngrehinë mermeri ngjyrë e zezë dhe ndryshku me emrin e kreut të partisë bolshevike që binte fort në sy.

Ora e kullës shënonte 16.20. Një lloj shqetësimi endej në ajër dhe po të këqyrje sheshin dukej se turistët, shumë syresh kinezë e japonezë, lëviznin si me ngadalësim.

Në majë të kullës shkëlqente ylli i kuq prej qelqi rubin me draprin dhe çekanin në mes, simboli i pushtetit sovjetik që më 1935 i zuri vendin shqiponjave perandorake mbi kullat më të larta të Kremlinit. Turistët shkrepnin foto dhe selfie para 2235 metrave mure që qarkonin fortesën e pamatë, mospërfillës për atë që ndodhte brenda tyre.

Nga dera e Spasskaja-s doli një vajzë e bukur, e veshur me sqimë, që punonte në zyrën e shtypit të presidentit. Mbërriti e përpiktë në takim, e shoqëruar nga asistentja. Por, para se të hynim, duhet të prisnim edhe përkthyesit, që me sa dukej ishin me vonesë. Kur mbërritën, na shoqëruan në një zonë të Kremlinit të mbyllur për turistët. Ra një heshtje krejt e veçantë.

Stafi i zyrës së presidentit Putin na parakaloi pa folur. Njerëzit e sigurisë i mbështillte ai tis fshehtësie dhe devotshmërie tipike për profesionin. Ecëm përgjatë

pallateve disa minuta derisa mbërritëm te një portë hekuri e zezë që shënjonte hyrjen në zonën e administratës presidenciale. Po mateshim të hynim në pallatin numër një, pallati pas mureve ku kishin jetuar dhe qeverisur Lenini dhe Stalini, që të dy banorë të kësaj fortese hijerëndë dhe kanosëse edhe sot e kësaj dite.

Ndodheshim brenda zonës së ndaluar, në oborret e Pallatit të vjetër të Senatit, një ndërtesë neoklasike e bardhë dhe e verdhë në okër, e lindur në Rusinë perandorake, që pas revolucionit bolshevik u bë selia e parë e qeverisë sovjetike. Megjithë zhegun mbytës, u ngjetha i tëri. Ndihej pesha e historisë përreth nesh, historia e Nënës së Madhe Rusi.

Hymë thujse përvjedhtas nga një deriçkë anësore që mbante numrin shtatë. Çantat na i kontrolluan me kërkues metalesh në një dhomë të vogël e të zhveshur. Pas pesë minutash të tjera, përshkuam një korridor të bardhë, të gjatë e klaustrofobik. Teksa ecja në atë korridor, vetja më dukej si në një film të Xhejms Bondit, *Nga Rusia me dashuri*. Atmosfera ishte ajo e trillerave të kohës së Luftës së Ftohtë. Ndodheshim brenda në Kremlin dhe gjithçka ishte e vërtetë, gjithçka.

Vazhduam përpara, ngadalë, gjithnjë pa pipëtirë, pastaj morëm një ashensor me xhama i cili shihte në një oborr të brendshëm që dukej qartë se nuk përdorej. Ndaluam në katin e dytë. Kishim mbërritur. Ndodheshim në zemrën e pushtetit të Rusisë së Vladimir Putinit, për shumë njerëz njeriu më i fuqishëm i Tokës. Ishim në qendrën nevrologjike të Kremlinit, në Pallatin numër një, ku një rresht dhomash pritjeje luksoze, të mobiluara plot sqimë, të çonin në studion e presidentit.

Ai krah i pallatit në stil neoklasik ishte luks i gjallë. Gjithçka rrezatonte përsosmëri. Në muret që zbardhnin thekshëm ishin varur pamje historike të Kremlinit dhe Sheshit të Kuq. Në të djathtë një mori dyersh me numra, të lyera me të bardhë dhe të zbukuruara me stoli të praruara. Çdo imtësi rrezatonte përkujdesje, dorezat e arta ishin të punuara me gdhendje. Hera-herës, në rrugë e sipër, të zinte syri ndonjë aparat telefonik të dalë mode, stil sovjetik.

Dhe ja tek mbërritëm në Dhomën e Oxhakut, vendi “i shenjtë” i zgjedhur nga Putini për takimin. Ndodhej në zonën veri-lindore të Kremlinit, një zonë e ruajtur me rreptësinë më të madhe. Pikërisht këtu punonte, komandonte, vendoste mbi fatin e vendit të tij dhe lëvizjet gjeopolitike Vladimir Putini, një kryetar shteti dhe një njeri që mund të shkruante dhe rishkruante historinë, që një hap e ndante nga një car.

Vetëm katër dhoma e ndanin Dhomën e Oxhakut nga zyra personale e Putinit. Pikërisht këtu më 1940 gjendeshin apartamentet dhe zyra e Stalinit. Me ndryshimin që stili sovjetik ishte zëvendësuar nga ari, stukot dhe mobilet e stilit perëndimor.

Sot mund të ecje në parkete të rafinuara, të riprodhuara sipas modës së shekullit XVIII, me gdhendje në dru të çelët e të errët që paraqisnin figura gjeometrike dhe floreale, rozeta* dhe ***motive*** greke. Llambadarë madhështorë prej ari dhe kristali

* Rozeta është një element dekorativ në formë dritareje të madhe rrethore në fasadat e kishave të stilit romanik dhe gotik. (Shënim i përkthyesit).

vareshin plot hijeshi nga tavanet e stukuara mjeshtërisht, që kishin diçka prej stilit të Versajës. Perdet e rënda të qëndisura ishin luksoze, baroke, tapiceritë të çmuara.

Pak metra larg, Putini po zhvillonte një takim me Këshillin e ministrave, ku ishte i pranishëm edhe Dmitrij Medvejevi, alter egoja e tij dhe aktualisht kryeministër i Rusisë.

Zyra e Putinit kishte një portë të madhe të dyfishtë të bardhë me zbukurime ari përgjatë paneleve. Prej aty presidenti hynte drejt e në dhomën ku priste krerët e shtetit, Salla e Samiteve. Në njërën nga dhomat, që njihej menjëherë sepse shfaqej shpesh në televizion në raste takimesh me krerët e qeverive të huaja, shqiponja dykrerëshe, e shumëfishuar pafundësisht, spikaste mbi tapiceritë prej kadifeje të kuqe. Dikur simbol i perandorëve bizantinë dhe më pas i Habsburgëve dhe dinastisë Romanov, sot ishte stema e presidencës së Rusisë. Në qendër, syri të zinte një Shën Gjergj që vret dragoin.

Vazhdonte më tej një tjetër dhomë pritjeje, ajo me mure të kaltra, dhe u gjendëm para një tryeze të madhe të bardhë. Ndalua pak këtu për të këmbyer dy fjalë me njerëzit e presidentit, një filxhan çaj dhe një bashkëbisedim për shanset e Hilari Klintonit, Donald Trampit dhe Xheb Bushit në fushatën për Shtëpinë e Bardhë në Amerikë.

Mbi tryezë kishte disa tabaka me tartina gjithfarëshe, kryesisht me bazë peshku. Nuk mungonin *pirožki*-t, paninet e vogla të mbushura me lakër ose mollë. Gjithçka sipas traditës së kuzhinës ruse. Tashmë ndodheshim pak metra larg zyrës personale të Putinit, ndërsa po kalonim pasditen me stafin e tij. Ishim të lirë të shëtisnim në zonën presidenciale, të bënim fotografi si kujtim dhe të shijonim bukurinë e mobilimit. Njerëzit e sigurisë me kostume të errëta dhe kufje na këqyrnin, me vështrimin e dikujt që është mësuar me vizitat e të ftuarve vip të presidentit, pak a shumë të stilit Secret Service në Shtëpinë e Bardhë.

Pak përpara orës 19, tërë stafi u shpërngul në sallën përbri me atë të oxhakut. Operatorët rregulluan telekamerat. S' mbetej veçse të pritnim Putinin. Figura të ndryshme, tashmë të njohura për ne, vërtiteshin në "dhomat e vendimmarrjes". Një koleg fjalëshumë që punonte për zëdhënësin e presidentit, Dmitrij Peskov, po fliste dashamirësisht për politikën ndërkombëtare, nën vështrimin e rreptë të portreteve të admiralit Ushakov dhe gjeneralisimit Suvorov, një ndër të paktët që mund të mburrej se kishte qenë i pathyeshëm në mëse gjashtëdhjetë beteja. Të gjithë po pritnin qetësisht, durimplotë me presidentin e tyre, por sidomos të mësuar me ritmet e tij.

Rreth orës 19.45 erdhi njoftimi zyrtar që presidenti do të mbërrinte pas pak. Tensioni mes anëtarëve të stafit u rrit, të gjithë iu drejtuan vendeve të tyre, kameramanët u bënë gati për të filmuar. Njerëzit e sigurisë nisën të zënë vendet përkatëse, thujse si një trupë speciale, përgjatë dyzet metrave që Putini duhet të përshkonte për të mbërritur në Sallën e Oxhakut.

Në tetë fiks u hapën kanat më kanat dyert e dyfishta të zyrës së presidentit të Federatës ruse dhe mbërriti Vladimir Vladimiroviç Putini. Presidenti ndiqej nga

zëdhënësi Dmitrij Peskov dhe pjesëtarët e stafit të tij. Pas disa sekondash dhe atyre dyzet metrave largësi, Putini kapërceu pragun e Dhomës së Oxhakut.

Mbërritja e presidentit ishte si një rrymë ajri siberiane. Hapin e kishte të vendosur por fytyrën e kishte të nderë e të tendosur. Rrezatonte autoritet dhe pushtet. S'qe e vështirë ta përfytyroje ndërsa përshkonte në heshtje dhomat e fshehta të Kremlinit dhe përgatitej të merrte vendime që mund të ndryshonin fatin e shumë vendeve, të shumë njerëzve. Prania e tij në sallë pati efektin e një shkarkese elektrike. Befas, të pranishmit i përfshiu nervozizmi dhe tensioni endej në ajër. Jashtë terri kishte gllabëruar ditën, shiu rrihte zhurmshëm xhamat e dritareve të mëdha. Telekamerat ishin gati për të filmuar, mikrofonat po regjistronin tashmë.

Vladimir Putini më përshëndeti. Në më pak se dhjetë sekonda zuri vend në karrigen përballë oxhakut, në stilin tradicional të bisedimeve me liderët e tjerë. Vetëm shkrepjet e fotografit zyrtar thyen heshtjen që pllakosi befas fill pas shfaqjes së njërit prej njerëzve më të fuqishëm të Tokës. Presidenti kishte veshur një kostum blu me këmishë të bardhë dhe një kravatë blu. Këpucët e zeza prej lëkure të merrnin sytë me shkëlqimin e tyre. Pamja e tij s'kishte të sharë, nuk i lëvizte as qimja.

Fillimisht vështrimin e kishte të padepërtueshëm. Pastaj, brenda pak minutash, burri me sy të akullt, gjuetari i arinjve, eksperti i arteve marciale mori një qëndrim të shtendosur dhe të natyrshëm. Ndodhi kur i përçolla përshëndetjet e mikut të tij Silvio Berlusconi. Në kufje, dëgjohej zëri i përkthyesit i këputur nga emocioni. Kur Putini nisi të fliste për mikun Silvio, zëri sikur iu shkri, u bë më i mbytur dhe më i thellë.

Gjatë bisedës, Vladimir Putini, kur përshkruante mikun Silvio, tha disa herë "Silvio". Sepse ashtu e thërriste ai. Thjesht Silvio. Ndihej i rehatuar dhe ndërsa akrepat e orës ndiqnin njëri-tjetrin, u bë më i përzemërt dhe fjalëshumë, duke buzëqeshur i zbavitur. Ndërsa fliste, luante me fillin e kufjes teksa lëvizte këmbët në mënyrë të kontrolluar. Por midis Silvios dhe Vladimirit dukej që ekzistonte një empati e madhe. "Kemi krijuar edhe një raport personal, shumë të mirësjellshëm."

Tani i zgjidhte fjalët me kujdes, por u duk mjaft i vendosur kur shfaqti opinionin e tij rreth Berluskonit.

"Fakti është që Berlusconi ka qenë politikan që ka qëndruar më shumë në pushtet në historinë e pasluftës të Italisë. Kjo dëshmon që jo thjesht ka ditur të tërheqë vëmendjen e italianëve te vetja, por t'i bindë që veprimet e tij kanë qenë në përputhje të plotë me interesat e popullit italian. Kjo pikësëpari," tha Vladimir Putini, i mbështetur me shpinën drejt në karrigen para oxhakut të mermertë. "Së dyti, është një person i shkëlqyer, i çiltër, shumë interesant dhe e gjithë kjo, në tërësi, pa dyshim që përbën arsye për të besuar se Silvio Berlusconi, si politikan dhe si njeri, me siguri do të zërë një vend plotësisht të respektuar në historinë e Italisë." Por ka edhe më shumë: "Në fillim të viteve Dymijë, në 2002-shin, u bë nismëtar i marrëveshjes midis Ruisë dhe Nato-s dhe në këtë pikëpamje ka luajtur një rol të qenësishëm në normalizimin e situatës në

Evropë, jo vetëm në kuadrin e marrëdhënieve italo-ruse, por edhe në një rrafsh shumë më të gjerë”.

Kështu foli Vladimir Putini. Ky ishte mendimi i njërit prej më të fuqishmëve të planetit për Silvio Berluskonit.

Po kush është dhe nga vjen Silvio Berlusconi?

Kush është Berlusconi i vërtetë?